



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 13.09.2011, ora 13:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Saša Milosavljeviq, Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhavit Haliti dhe Fatmir Limaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Vela, Sanije Berisha – OSBE, Arban Abrashi dhe Venera Mjekiçi – Kuvend, Artan Canhasi- EULEX, Pela Blass-EU TAIEK.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri - Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me dt. 26.07.2011, 23.08.2011, 26.08.2011 dhe 29.08.2011;
3. Takimi me u.d. të shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë – z. Khaldoun Sinno;
4. Raportim i Ministres për Integritet Evropian – znj. Vlora Çitaku;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i pëRaporti i Progresitutshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet si ne vijim.

3. Takimi me u.d. të shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë – z. Khaldoun Sinno;

4. Raportim i Ministres për Integrim Evropian – znj. Vlora Çitaku;

Kryesuesi tha jam i nderuar që sot në këtë dëgjim komisioni të falënderoi ministren e Integrimeve Evropiane si dhe u.d. të shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian z. Sinno meqë është raportimi i dytë i ministres para komisionit dhe jemi në prag të publikimit të raportit të Komisionit Evropian. Pra janë pak ditë që kanë mbetur që në kuadër të kësaj me angazhimet tona të bëjmë eventualisht përmirësimin teknik të raportit. Nga ana tjetër tha kemi letrën e komisionarit Fyle adresuar Qeverisë dhe Kuvendit për arritjen e objektivave deri në shtator. Sa i përket Kuvendit në përgjithësi është përmbushur kërkesa për miratimin e legjislacionit përveç dy ligjeve që përfshijnë edhe ligjin për financimin e RTK-së. Në pjesën e dytë të fjalimit të juaj Ministre duam të dimë për një proces që është i ndarë nga ky proces e që është procesi i liberalizimit të vizave, pasi kemi delegacionin vlerësues në Prishtinë këto ditë. Pra duam të dimë nga afër se si apo në çfarë shkalle janë pritjet e Qeverisë në mënyrë që ky proces të merr më vonë pritje.

Fjala për znj. Ministre menjëherë pas jush z.Sinno.

Vlora Çitaku- Ministre për Integrim Evropian- tha Raporti i Progresit nuk do të jetë as pozitiv, as negativ por do të jetë real. Raporti i Progresit tha nuk është produkt negociimi por është dokument i cili bazohet në parametra shumë të matshëm siç janë: infrastruktura ligjore, faza e implementimit dhe një shumësi detyrimesh tjera të cilat lidhen me punën e mekanizmave tjerë institucional posaçërisht atë të gjyqësorit, policisë, media e me radhë. Duke pas parasysh kontestin kohor dhe procesin e stërzgatur elektoral, krizën e më pas-shme institucionale, institucionet e Republikës së Kosovës kanë pasur një afat jashtëzakonisht të shkurtër kohor për të adresuar sfidat e Raportit të Progresit. Njoftoi që javën e ardhshme do të jetë në Bruksel ku së bashku me Komisionin Evropian do të bëjnë leximin e Raportit të Progresit pasi hartimi i Raportit të ri të Progresit tashmë ka filluar që nga 1 shtatori i këtij viti ndërkohë që përgjigja zyrtare nga ana e Zyrës së Komisionit Evropian do të vjen tek në dhjetor me mbajtjen e Këshillit të Ministrave ku priten të jepen edhe rekomandimet e tjera pas leximit të Raportit të Progresit. Ftoi që si Parlament të trajtojnë me prioritet ligjet të cilat kanë mbetur pa u miratuar e të cilat kanë qenë të identifikuar si ligje të rëndësishme dhe të nevojshme nga Raporti i Progresit i vitit të kaluar. Procesi i integrimit evropian tha duhet të jetë pjesë integrale e punës sonë të përditshme. Jam shumë e kënaqur që ligjet të cilat lidhen posaçërisht me rendin dhe luftimin e korrupsionit kanë kaluar në Kuvend. Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave konfirmoi që në Kosovë ka arritur Misioni Vlerësues i Komisionit Evropian. Ky Mision do të vizitojnë disa Komuna të Republikës së Kosovës

ku mbi bazën e vlerësimeve që do të nxjerr do të përgatiten rekomandimet e Komisionit për Këshillin e Ministrave lidhur me hapjen e dialogut përkatësisht marrjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Tregoi se nga vizitat personale që kishte në të gjitha Komunitetet e Kosovës ka vërejtur një progres të jashtëzakonshëm në të gjitha komunitetet dhe se të gjitha Komunitetet e trajtojnë me prioritet procesin e riintegritimit të personave të riatdhesuar. Njoftoi se është shumëfishuar numri i aplikacioneve për përfitim nga fondi për riintegritimin e personave të riatdhesuar. Ne tha se i përket procesit të riintegritimit jemi shumë përpara edhe në krahasim me disa vende të rajonit të cilat tashmë kanë përfituar nga procesi i liberalizimit të vizave. Unë u kam dërguar një raport të përmbledhur mbi bazën e kërkesës që kam marr nga ju dhe jam në dispozicionin e juaj për të dhënë çdo sqarim.

Kryesuesi falënderoi Ministren për prezantimin dhe raportin voluminoz dhe detaj të dërguar. Paraprakisht tha e falënderoi Komisionin Evropian për mbështetjen që po i jap Komisionit tonë ku një numër i deputetëve kanë qenë për vizitë studimore në Bruksel ndërsa pjesa tjetër pritet të shkojnë mbas 12 tetorit si dhe për një punëtori që organizohet nga TAIEK-i. Fjalën ia dha z.Sinno.

Khaldoun Sinno - tha është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi në mes Komisionit për Integritet dhe Qeverisë është i një niveli shumë të mirë dhe kjo është një çështje të cilën e kemi raportuar edhe në Raportin e kaluar të Progresit si të arritur. Sa i përket Raportit të Progresit tha siç e dini ne asnjëherë nuk japim informata paraprakisht kështu që unë nuk do të mund të ju tregoj se çka do të përmbaj raportin e ardhshëm. Publikimi i Raportit të Progresit, do të jetë me 20 tetor. Shtoi do të kemi leximin e Raportit të Progresit në Bruksel. Sa i përket Raportit të kaluar të Progresit ju tha e dini përmbajtjen e tij andaj unë skam pse ta përsëris prapë. Raporti i Progresit tha hartohet për shtetet të cilat aspirojnë të integrohen në Evropë pavarësisht se sa do të zgjas ky proces, është një vlerësim të cilin e bënë Komisioni Evropian se sa është i gatshëm një shtet për tu bërë pjesë e BE si në aspektin ekonomik, politik dhe sektorial. Sa i përket problemeve ekonomike, shoqërore e të tjera janë probleme të cilat duhet të zgjidhen jo vetëm pse janë parakushte për anëtarësim në BE por gjithashtu sepse janë për të mirën e qytetarëve të Kosovës. E njëjta mënyrë e vlerësimit është duke u bërë që nga vitet e 90-ta për vendet e Ballkanit përfundim andaj kjo është forma e cila po aplikohet edhe në Kosovë. Raporti i Progresit bazohet në shumë burime andaj ne bëjmë shumë përpjekje që të marrim inputet nga Qeveria, OJQ-të, inputet nga projektet tona dhe i verifikojmë kështu që ju siguroi që të dhënat nga Raporti i Progresit janë të dhëna shumë të sakta. Duke e parë rëndësinë e këtij Komisioni ne kemi ofruar për këtë komision një eksperte e cila do të jetë këtu për të ju ndihmuar ju. Kemi projektin e Binjakëzimit me Parlamentin Hungarez ku do të keni këshillim të përhershëm për dy vite. Potenco i që Parlamenti është një institucion kyç në çdo zhvillim andaj kjo nuk duhet të harrohet. Sa i përket çështjes së vizave siç e ka thënë edhe z.Barroso, ne do të shikojmë në kornizën e riintegritimit dhe nëse ne ndahemi të kënaqur ne do të lëvizim procesin përpara. Është misioni këtu ata do të sjellin të dhëna nga fusha duke u bazuar në vlerësimin e tyre.

Kryesuesi falënderoi z.Sinno dhe shtoi ka qenë vit i rëndësishëm sa i përket procesit dhe dinamikës së punës. Falënderoi rolin politik të kolegëve që vijnë nga partitë opozitare në

arritjen e konsensusit në mënyrë që të gjithë të punojnë bashkë në këtë agjendë. Njoftoi se në Komision kanë raportuar dy zëvendësministra dhe katër ministra. Njoftoi që kanë qenë në zyrën e Kryeministrit për të parë vonesën për disa ligje specifikisht, deputetët kanë qenë edhe në Zyrën e Avokatit të Popullit për disa nga problemet e evidentuara në Raport. Pyeti për Avokatin e Popullit sepse ai vazhdon ende të jetë i pa mbështetje dhe me problemet e tjera të njëjta. Fjalën ia dha deputetes Alma Lama.

Alma Lama fillimisht bëri një konstatim në lidhje me raportet në mes Kosovës dhe BE-së ku gjykoi se ka një ngecje të mardhënieve. Ka vetëm një fushë ku po bashkëpunohet dhe ai është dialogu që po zhvillohet në mes Kosovës dhe Serbisë ku duket që Bashkimi Evropian është më i interesuar në lidhje me këtë çështje. Këtu folëm për liberalizimin që është proces i ndarë por pavarësisht ka të bëjë me Bashkimin Evropian i cili ka mbetur në vend numëro prej shumë kohësh. Po kështu kemi një ngecje edhe tek çështja e marrëveshjeve tregtare, preferencat tregtare dhe ndoshta z.Sinno do të duhej të na jepte një shpjegim se pse Kosova po bllokohet në njëfarë mënyre nga Bashkimi Evropian në lidhje me këtë çështje. Në lidhje me raportin që kemi marrë nga ministria e Integriteteve ishte një raport shumë i gjerë. Një pjesë e të dhënave dhe të arriturave ishin të vitit 2010 e jo të periudhës së fundit. Për çështjen e buxhetit prej 3.5 milion eurosh tha ka pasur një shfrytëzim shumë të vogël nga ana e Komunave të buxheti që herën e kaluar ka qenë 1%. Do të doja të shihnim progresin e këtyre tre muajve. Shtoi ka një ngecje në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtar. Këtu na janë paraqitur vendet të cilat kryesisht gjatë vitit 2010 e kanë nënshkruar marrëveshjen me Kosovën por gjatë vitit 2011 ka një ngecje ku vetëm dy-tre vende kanë arritur të nënshkruajnë. Pyeti pse shtetet e tjera po hezitojnë apo është problemi këtu tek ne dhe realisht çfarë ka bërë ministria e integriteteve për ta tejkaluar këtë situatë ndoshta dhe në bashkëpunim edhe me Ministrin e Punëve të Jashtme.

Kryesuesi i dha fjalën deputetes Vjosa Osmani.

Vjosa Osmani pyeti z.Sinno lidhur me ndërlidhjen që po tenton të bëjë Qeveria kohë pas kohe në mes të dialogut që po zhvillon Kosova me Serbinë dhe procesit të liberalizimit të vizave. Ndoshta ju si Komision Evropian mund ta qartësoni nëse vërtet procesi i dialogut është paraqitur ndonjëherë nga ana e Bashkimit Evropian si parakusht për institucionet e Kosovës që procesi i liberalizimit të vizave të ecë më shpejtë. Shtoi kemi insistuar që Qeveria mos ti lërë të gjitha ligjet për momentin e fundit sepse pastaj Kuvendi po vëhet në një pozitë të miratimit të tyre me procedura të përshpejtuara. Kështu, ndodhë shumë shpesh që përkundër deklaratës për përafrim me legjislacionin e BE-së që e përgatit ministria e juaj, dalin çështje të cilat nuk kanë qenë në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së. Kërkesa ime tha është që Ministria të jetë pak më e kujdesshme lidhur me këtë proces sepse ne si Komision kemi rënë në një pozitë shumë të pafavorshme pasi lejohet ti përafrojmë vetëm amendamentet që vijnë nga komisionet funksionale dhe jo ligjin në tërësi. Shembull morri ligjet që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale. Sa i përket ligjeve për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe korrupsionit, në veçanti Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Mbrojtjen e Informatorëve tha kemi miratuar ligjet të cilat kanë zero buxhet. Në Raportin e vitit 2010 ne nuk jemi kritikuar vetëm se nuk ekzistojnë ligjet por se nuk ekziston një sistem për mbrojtjen e

dëshmitarëve. Tha tani po supozoi se në Raportin e ardhshëm do të kritikohemi se kemi ligje në sirtarët tanë mirëpo në procesin e zbatimit të tyre jemi shumë mbrapa.

Suzan Novoberdali – sa i përket ligjeve tha ne me një procedurë shumë të përshpejtuar i kemi miratuar afër 40 ligje. Meqë jam kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut konsideroi të arsyeshme që të njoftoi se tek përzgjedhja e zëvendës ombduspersonit kemi marr një përgjigje se përzgjedhja është bërë në bazë diskriminuese kjo për arsye se është shkel Ligji për Barazi Gjinore ku nga pesë zëvendës avokatët e popullit vetëm njëra është femër. Në këtë drejtim Komisioni do të kërkoj që të bëhet plotësimi i kësaj liste me edhe një femër.

Blerim Shala tha ekziston një masë të madhe një lloj keqkuptimi se Raporti i Progresit dedikohet ekskluzivisht miratimit të ligjeve nga Kuvendi i Kosovës, ku kemi pasur edhe tensione në relacionin në mes Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Raportet e të cilave kanë qenë objekt shqyrtimi edhe i Raportit të Progresit të vitit të kaluar dhe kanë qenë objekt të kritikës. Shtoi na është thënë nga autoritetet e Brukselit me vend që miratimi i ligjit është vetëm hapi i parë në rregullimin e jetës politike, shoqërore, ekonomike në një vend e që zbatimi i ligjit ka po aq rëndësi në mos edhe më shumë rëndësi. Në aspektin e miratimit të ligjit tha i kemi dy aspekte. Segmenti i parë ka të bëjë me raportin në mes Komisionit Evropian dhe Kosovës dhe që lidhet me raportin e Progresit, ndërsa segmenti i dytë po aq i rëndësishëm ka të bëjë në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në Marrëveshjen që e ka Qeveria me Fondit Monetar Ndërkombëtar theksohet qartë se një ligj nuk mund të miratohet nëse nuk ka garancë buxhetore për pesë vite. Ne kemi problem me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i cili de fakto dhe de juro do të hyj në fuqi 24 muaj pas miratimit të tij. Është mirë që ka konsensus midis nesh sa i përket agjendës evropiane. Është mirë që ka konsensus në BE sa i përket perspektives evropiane të Kosovës, por këto dy konsensusë duhet të operacionalizohen, e ju e dini që ky operacionalizim nënkupton krijimin e raporteve kontraktuale. Pyeti a mundet ky konsensus që ekziston midis nesh dhe brenda nesh të krijoj rrethana më të volitshme se sa ato që janë aktualisht në fuqi e që në fakt kemi të bëjmë me mekanizma që mund ti quajmë mekanizma hibrid për raportet në mes Prishtinës dhe Brukselit.

Blerta Deliu-Kodra pyeti z.Sinno se në bazë të disa hulumtimeve që janë bërë nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare Kosovës i janë kërkuar kritere të shumëfishta për marrjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave nga Brukseli se sa vendet e tjera që kanë kaluar në këtë proces.

Albert Kinolli pyeti ministren se kur do të filloi lëshimi i pasaportave biometrike.

Kryesuesi i dha fjalën Ministres për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Vlora Çitaku- Ministre për Integrim Evropian – lidhur me pasaportat biometrike tha, ka përfunduar procesi i tenderimit dhe nënshkrimi i kontratës me kompaninë për prodhimin e pasaportave biometrike. Specimenti i parë i pasaportës biometrike tashmë është prodhuar ndërsa qytetarët me pasaporta biometrike do të fillojnë të pajisen nga muaji tetor. Shtoi nuk kemi arritur ta konkretizojmë këtë konsensus që ekziston në mes

nesh dhe BE-së në formë kontraktuale por besojmë që në fund të këtij viti Këshilli i Evropës do të rekomandojë vendosjen e marrëdhënjëve kontraktuale posaçërisht ofrimin e mundësisë që Kosova të marr pjesë në programet e komunitetit e që kjo do të shënonte hapin e parë kontraktual në mes Kosovës dhe BE-së. Lidhur me cilësinë e ligjeve tha ne kemi evidentuar që ka mungesë të kapaciteteve në zyrat ligjore në kuadër të ministrive. Ministria për Integritet Evropian tha ka përfituar një projekt 3 milion eurosh nga Qeveria Gjermane në asistencë teknike ku pjesa më e madhe ndërlidhet me përmirësimin e legjislacionit. Në këtë fazë të procesit ne tha lëshojmë vetëm deklaratë të pajtueshmërisë e jo të përputhshmërisë. Ligjet pa zbatimin e tyre nuk e kanë vlerën mirëpo hartimi dhe miratimi i tyre është parakusht për zbatim. Sa i përket Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve tha në Kosovë ka një sistem për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të Policisë së Kosovës, po ashtu ka marrëveshje me disa shtete për mbrojtjen e dëshmitarëve. Lidhur me marrëveshjet për riatdhesim konfirmoi se në një afat prej dy javësh do të nënshkruajnë edhe tri marrëveshje tjera me Hungarinë, Finlandën dhe Suedinë. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve tha është një punë shtesë që i është shtuar Kosovës për shkak të mungesës së marrëdhënieve kontraktuale me BE-në. Tha dua të ju siguroi që Komisioni Evropian është partner i Kosovës dhe se Komisioni Evropian nuk është organi i cili merr iniciativën për hapjen e dialogut apo për vendosjen e marrëdhënjëve kontraktuale por është organ që rekomandon ndërsa vendimi përfundimtar është në duar të Këshillit Evropian. Sa i përket fondit 3.5 milionësh tha nuk jam e kënaqur me numrin e aplikacioneve të cilat janë deponuar tek bordi për Implementimin e Strategjisë për integrimin e personave të Riatdhesuar sepse deri më tani janë shpenzuar vetëm 10% të fondit. Nuk guxojmë që për hir të përmbushjes së një kuote në përqindje fondi të përfundoi në duart e atyre që s'ju dedikohet.

Alma Lama tha problemi që na keni ngritur herën e kaluar ka qenë mungesa e aftësive të zyrtarëve komunal për të bërë projekte dhe për të përfituar nga ky fond.. Çfarë është bërë me këtë sepse vlera ende është shumë e ulët.

Vlora Çitaku- Ministre për Integritet Evropian – shpenzimi i buxhetit të fondit diktohet nga ana e aplikacioneve që vijnë në adresë të fondit nga ana e zyrtarëve komunal. Pas trajnimeve që kemi bërë me rreth 220 zyrtar komunal, numri i aplikacioneve është shumëfishuar.

Kryesuesi tha numri i të kthyerve mund të rritet në muajt e ardhshëm kështu që buxheti është për të prit, mirëprit dhe akomoduar gjithë ata që kthehen nga shtetet perëndimore, shtete anëtare të BE-së. Ftoi z.Sinno.

Khaldoun Sinno tha dy qëllimet ardhja më afër Evropës dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve janë të ndërlidhura. Komisioni Evropian i ndihmon Kosovës shumë kështu në vitin 2009 kemi lansuar studimin për Kosovën ku kemi propozuar çështje konkrete, njëra prej çështjeve shumë të suksesshme është Dialogu i Stabilizim Asocimit ku tani kemi rrethin e dytë të tij. Sa i përket marrëveshjeve tregtare tha është e vërtetë që nuk kemi arritur sukses por kjo nuk do të thotë se asgjë nuk ka ndodhur sepse vitin e kaluar kemi pasur një mision i cili ka vlerësuar se çka duhet bërë për të arritur marrëveshjen tregtare. Po ashtu çështja e marrëveshjes tregtare tha është çështje politike për të cilën duhet të

gjenden mënyra se si do t'iu propozohet shteteve anëtare. Sa i përket tregtisë shpresoj që në këtë vjeshtë do të kemi rivlerësimin i cili është shumë i rëndësishëm. Jemi shumë të lumtur që në tërë Kosovën ka vullnet për integrim në Bashkimin Evropian. Sa i përket legjislacionit dhe letrës së Komisionarit Fyle për institucionet e Kosovës tha është bërë nga dëshira për të ju inkurajuar që të punoni në diçka që ne e konsideronim që mund të bëhej. Jemi të vetëdijshëm për shpejtësinë e miratimit të ligjeve por gjithashtu duhet të jenë edhe kualitativ sepse njëra se përjashton tjetrën. Në këtë nivel ligjet tha nuk duhet të jenë 100% të përshtatura me legjislacionin e BE-së . Sa i përket çështjes së vizave tha është misioni vlerësues këtu dhe do të vlerësojnë punën që është bërë deri më tani. Shtoi ministri i kaluar ka përgatitur një anshëm udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave andaj shumë punë janë bërë në këtë drejtim dhe shpresoj që jemi në drejtim të mirë për të arritur procesin e liberalizimit. Sa i përket dialogut tha dialogu është i rëndësishëm për ju sepse ju i keni fqinjë dhe ju nuk mund të zgjidhni se kush do të jenë fqinjtë e juaj. Ne e kemi lansuar dialogun dhe jemi të kënaqur që kishim një takim të suksesshëm. Bashkëpunimi rajonal është shumë i rëndësishëm në procesin e stabilizim asocimit dhe ne e përcjellim këtë bashkëpunim në të gjitha shtetet e rajonit. Në mënyrë që të afroheni në procesin integritetit ju duhet të keni bashkëpunim të mirë rajonal. Ne asnjëherë nuk kemi bërë lidhjen në mes dialogut dh procesit të liberalizimit të vizave.

Kryesuesi në deklaratën ndër-parlamentare në mes Kuvendit dhe Parlamentit Evropian është rikonfirmuar angazhimi dhe përkushtimi i jonë në këtë proces dhe besoj se Kuvendi do ta mban këtë përkushtim. Në planin e punës së Kuvendit është paraparë që Kuvendi i Kosovës të hap një zyre në Parlamentin Evropian sepse është institucioni i vetëm në BE që e njeht pavarësinë e Kosovës për dallim nga institucionet e tjera të cilat kanë qëndrim neutral e që paraqet vështirësi për të gjithë ne. Do të jetë çështje e Kryetarit të Kuvendit për kohën dhe mënyrën që do të jetë. Konsensusi që është arritur do të ruhet vetëm nëse ka angazhime konkrete dhe të përbashkëta. Shtoi shpresojmë që takimi ynë i radhës do të jetë menjëherë pas publikimit të Raportit të Progresit për të parë se si është cilësuar dhe të ndërtojmë politikat e tjera për të vazhduar rrugën drejt këtij procesi. Pyeti a do të ketë delegacion të Qeverisë së Kosovës në Bruksel për të negociuar dhe apo jo. Falënderoi për raportim.

Vlora Çitaku- Ministre për Integrim Evropian tha unë javën e ardhshme do të jem në Bruksel së bashku me një ekip të ekspertëve, ku do të kemi takim me z. Pier Mirel dhe komisionarin Fyle ku do të bëhet leximi e jo negociimi i Raportit të Progresit.

Kryesuesi ftoi zëvendës-kryesuesin Sasa Milosavljeviq që të vazhdoj udhëheqjen e mbledhjes.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me dt. 26.07.2011, 23.08.2011, 26.08.2011 dhe 29.08.2011;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi - E ftoi deputetin Blerim Shala, referuese i këtij Projektligji ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerim Shala -Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni një zëri e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e Komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Të ndryshme.

a) Mënyra e raportimit të ministrave para Komisionit.

Alma Lama propozoi, në rastet kur ministrat përcjellin raportet e tyre me shkrim të mos bëjnë prezantimin e raportit të dërguar por të fillohet me parashtrimin e pyetjeve nga ana e deputetëve në mënyrë që të ketë kohë më shumë për sqarimin e pa qartësive që mund ti kenë deputetët rreth ati raporti.

Propozimi i deputetes u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit
Lutfi Haziri